2-1 74
10 01 18

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Qeveria - Vlada - Government**

| | | |
|---|---|---|
| MINISTRIA E ARSIMIT E | MINISTRASTVO OBRAZOVANJA | MINISTRY OF EDUCATION |
| SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË | NAUKE I TEHNOLOGIJE | SIENCE & TECHNOLOGY |

## LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | | **2/1-08** | | | |
| **PËR/ZA/TO:** | | z. SHYQIRI BYTYQI, MINISTËR I MASHT-i<br>z.Bajram Kosumi , Rektor i Universitetit Publik "Haxhi Zeka "në Gjilan | | | |
| **CC:** | | | | | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | | | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | | Vebi Ismajli - drejtor i NJAB | | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | | Raporti Final në Universitetin Publik të Gjilanit | | | |
| **Nr. i zyrës:**<br>**Br. kancelarije:**<br>**Room No.:** | **212** | **Lokacioni:**<br>**Kucni:**<br>**Extension:** | **MASHT** | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | **10.01.2018** |

| | |
|---|---|
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | ☐ |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | ☐ |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED | ☐ |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | ☐ |
| **PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION** | X |
| AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE | |

Në letrën përcjellëse e keni të bashkangjitur Raportin Final të përfunduar në Universitetin Publik "Haxhi Zeka " në Gjilane.

Me respekt,

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

***Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology***

**Njësia e Auditimit të Brendshëm**

# RAPORTI FINAL I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA"GJILAN PËR PERIUDHËN

01.01.2017-30.09.2017

**Janar, 2018**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria -Vlada-Government*

***Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology***

Zyra e Sekretarit të Përhershëm/Kancelarija Stalnog Sekretar/Office of the Permanent Secretary

**Për:** **z. Shyqiri Bytyqi, Ministër i MAShT-it**
**z.Alush Istogu, u.d. Sekretar i Përgjithshëm i MAShT-it**
**z. Bajram Kosumi-Rektor i Universitetit Publik"Kadri Zeka" të Gjilanit**
**Nga:** **z.Vebi Ismajli – Drejtor i NJAB-së në MAShT**

**Lënda** : Menaxhimi i buxhetit, shpenzimeve dhe rekrutimi në Universitetin Publik"Kadri Zeka"Gjilan për periudhën 01.01.2017-30.09.2017

**Të nderuar,**

*Në shtojcë të kësaj shkrese keni të bashkangjitur Raportin Final bashkë me objektivat kryesore të dhënies së mendimit lidhur me përkatësinë e sistemit të brendshëm të kontrollit tuaj.*
*Raporti FINAL është bazuar në operacionet e kryera për menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimet e periudhës 01.01.2017 deri me 01.09.2017.*
*Shpresojmë që sugjerimet tona janë praktike dhe dëshirojmë bashkëpunim të mëtejmë me personelin e të audituarit, me qëllim të sigurimit dhe të zbatimit të rekomandimeve tona.*

*Me respekt,*
*Njësia e Auditimit të Brendshëm*

| | |
|---|---|
| **Bazuar në planin vjetor** | Auditimi Nr.8 |
| ORGANIZATA E AUDITUAR : | Universiteti Publik i Gjilanit |
| RAJONET E MBULUARA :<br>PROGRAMI/PROJEKTI/SISTEMI OPERACIONAL: | Menaxhimi i buxhetit dhe shpenzimeve në Universitetin Publik"Kadri Zeka"Gjilan për periudhër periudhën 01.01.2017-30.09.2017 |
| LLOJI I AUDITIMIT : | Përputhshmëria/ Performanca |
| KOHËZGJATJA E AUDITIMIT : | Dt. e fillimit - dt. e lëshimit 25.09.2017- 26.10.2017 |

**Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm:** Vebi ISMAJLI

**Udhëheqësi i Ekipit të Auditimit:** Vjollca HAZIRI

**Anëtarët e Ekipit të Auditimit:**

# PËRMBAJTJA


Shpjeguesi i shkurtesave....4

Përmbledhja ekzekutive....6

Hyrja....8

Qëllimi dhe fushëveprimi....9

Të gjeturat....14

Raportet Financiare....14

Shpenzimet e parave te gatshme....16

Tejkalimi i pagesave të Bordeve....16

Shpenzimet për telefona fiks dhe celular....16

Procedurat e shpenzimeve- prokurimi....19

Procedurat e Personelit....19

Konkluzionet....22

Rekomandimet....22

**Shpjeguesi i shkurtesave:**

- MAShT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- UPGJ Universiteti Publik i Gjilanit
- NJAB Njësia e Auditimit të Brendshëm
- AB Auditori i Brendshëm
- SHBE Shërbimi për Buxhet e Financa
- UA Udhëzim Administrativ

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Universiteti Publik i Gjilanit (UPGJ) është themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi themelimin e Universiteteve Publike më datë 6 mars 2013, të cilën e miratoi Kuvendi i Kosovës më date 31 maj 2013. Universiteti i Gjilanit gjendet në qytetin e Gjilanit, gjeogësisht në jug-lindje të Kosovës. Funksionimi i Universitetit te Gjilanit bëhet komform statutit të përkohshem i cili është miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të Republikës së Kosovës.

Ky auditim përfshin sistemin e bazuar në qasjen e auditimit të brendshëm që është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për auditimin e brendshëm. Për të gjitha të metat e konstatuara përgjatë auditimit, pas analizës së shumë mostrave - lëndëve, ku kemi vërejtur se ka mos funksionim të sistemit të kontrolleve të brendshëm, kemi bërë rekomandimet e duhura me qëllim të realizimit të misionit, objektivave dhe nën objektivave të UPGJ-së .

Auditimi i brendshëm është mekanizëm për të vlerësuar nivelin deri në të cilin kontrollet e brendshme në organizatën buxhetore janë adekuate për t`u siguruar që resurset e disponueshme janë duke u përdorur në mënyrë efektive dhe ekonomike për t`i arritur qëllimet zyrtare të saj.

Objektivat tona për këtë auditim janë përcaktuar në pajtim me vlerësimin e rreziqeve të lidhura me procesin.

Konkluzionet e përgjithshme të auditimit janë se:

- Me rastin e zhvillimit të këtij auditimi, NJAB-i vlerëson se ka dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm e sidomos **delegimit të detyrave dhe përgjegjësive.**
- Gjatë testimit detal të lëndëve të përzgjedhura për ekzaminim janë identifikuar mangësi lidhur me zhvillimin e procedurave në harmoni me rregullativën ligjore
- Gjatë analizave të bëra strukturës së Universitetit rezulton mungesë e stafit në Administratë.

Në bazë të konkluzioneve të lartpërmendura, ne kemi formuar mendimin tonë në lidhje me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e zbatimit të procedurave të menaxhimit të buxhetit dhe financave të cilën po e paraqesim në tabelën e mëposhtme.

| **Vlerësimi** | **Përshkrimi** | **Niveli i Shqetësimit** |
|---|---|---|
| Ka nevojë për përmirësim të menjëhershëm të sistemit të kontrolleve të brendshme dhe funksionim të drejtë të tyre. | Janë vërejtur dobësi të sistemit të kontrollit të brendshëm, të cilat mund ta bëjnë Menaxhmentin objekt për "dështime në arritjen e objektivave të përcaktuara". | Shkak për shqetësim |

## HYRJA

Universiteti i Gjilanit ka si objektivë primare që të tërheqë studentët potencial nga këto treva për shkak të afërsisë gjeografike dhe kostos më të lirë të jetesës që ofron Gjilani në krahasim me Prishtinën, kryeqytetin e Republikës se Kosovës.

Universiteti Publik i Gjilanit përbëhet prej tre njësive akademike:

- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i shkencave kompjuterike

Fakultetet e Universitetit janë të ndara në departamente në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit. Të gjitha Fakultetet ofrojnë studime të rregullta të nivelit bachelor në përputhje me dispozitat e statutit të Universitetit. Në projeksionet e këshillit themelues të UPGJ-së dhe rektoratit është edhe hapja e fakulteteve te reja ne një të ardhme të afërt.

Veprimtarinë dhe aktivitetin e punës UPGJ e ushtron duke u bazuar në rregullativën ligjore si vijon:

- Ligji mbi arsimin e lartë Nr. 04/L-037
- Statuti i Përkohshëm i UPGJ-së
- Rregulloret dhe aktet tjera normative në fuqi.

Auditimi i brendshëm në Universitetin e Publik të Gjilanit ka filluar me datën: 25/09/17, dhe Draft raporti i këtij auditimi është përgatitur dhe dorëzuar me datën 20/10 /2017.

Kemi bërë analizimin e objektivave të auditimit: menaxhimi i buxhetit, planifikimi, shpenzimet, rekrutimi, shpenzimet e telefonit, avanset dhe paratë e gatshme (petty cash-it) për periudhën kohore prej: 01/01/2017 deri me 30.09.2017

Auditimi është kryer nga ekipi i auditorëve të brendshëm të MAShT-it në këtë përbërje:

- Vebi Ismajli- Drejtor i auditimit të brendshëm
- Vjollca Haziri -Udhëheqëse e ekipit të auditimit të brendshëm

- **QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT**

Qëllimi i këtij auditimi të brendshëm është ekzaminimi dhe vërtetimi i gjendjes faktike të aktivitetit dhe veprimtarisë së punës së shërbimit të buxhetit dhe financave në përputhshmëri me rregullativën ligjore në fuqi.

Përgjegjësitë dhe veprimtaria e këtij shërbimi janë të rregulluara me aktet normative në fuqi si:

- Ligji nr. 03/L-048, për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Kontrolli i brendshëm i financave publike ( Rregulla e thesarit nr 01);
- Shpenzimi i parave publike ( Rregullat e Thesarit dhe Udhëzimet e Thesarit -02);

Ligji Nr. 03/L-149 – Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

1. Rregullore nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil
2. Rregullore nr. 03/2010 për përshkrimet e detyrave të punës
3. Rregullore nr. 05/2010 e orarit të punës
4. Rregullore nr. 06/2010 për transferimin e nëpunësve civil
5. Rregullore nr. 07/2010 për emërimin e nëpunësve civil
6. Rregullore nr. 04/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil
7. Rregullore nr. 05/2011 për procedurat e zgjidhjes së së kontesteve dhe ankesave
8. Rregullore nr. 06/2011 për pushimet e nëpunësve civilë
9. Rregullore nr. 01/2011 për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil
10. Rregullore nr. 02/2011 për punën provuese të nëpunësve civil
11. Rregullore nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civil

Pas analizimit të sistemit të kontrolleve të brendshme, duke u bazuar në nivelin e rrezikut për të gjitha proceset dhe procedurat jemi përqendruar në objektivat e cekura në vijim ashtu siç jemi pajtuar me Menaxhmentin e lartë gjatë takimit fillestar më 13.09.2017

**Objektivat e këtij auditimi janë:**

- Vlerësohet funksionaliteti i kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të personelit,
- Rekrutimi i stafit bëhen sipas rregullativës ligjore në fuqi
- Menaxhimi i buxhetit a është në pajtueshmëri legjislacionin në fuqi
- Të vlerësojmë nëse procesi i prokurimit funksionon në pajtueshmëri me Legjislacionin, politikat dhe udhëzuesit adekuat.

**Fushëveprimi i auditimit:**

Fushëveprimi i këtij auditimi janë të gjitha proceset si: procesi i rekrutimit dhe performanca e stafit, procedurat e prokurimit dhe buxheti ndërsa për testim jemi fokusuar vetëm periudhën janar-shtator 2017.

***Të audituarit:***

- Departamenti i Financave, Departamenti i Prokurimit dhe Departamenti i Personelit

***Metodologjia:***

- Intervistimi i zyrtarëve
- Testimi i mostrave
- Vëzhgimi fizik i punës

**Rreziqet**

- Mosfunksionim i kontrolleve të brendshme
- Mungesë e menaxhimit të drejtë dhe efikas të buxhetit
- Mos menaxhim efikas i procedurave të prokurimit
- Mosrespektimi i rregullativës ligjore gjatë fazës së rekrutimit

**Kontrollet**

- Detyrat dhe përgjegjësitë a janë të rregulluara me procedura
- A ekziston menaxhim i drejtë i fondeve publike
- Respektimi i rregullativës ligjore gjatë fazës së prokurimit

## 1. Të gjeturat

Në vazhdim të këtij raporti po i prezantojmë të gjeturat e auditorit sipas objektivave të parapara dhe të dakorduara me menaxhmentin e MAShT-it për Universitetin Publik të Gjilanit për periudhën 01.01.2017-01.10.2017.

Për të pasur një rrjedhë më të mirë struktura e raportit dhe për tu kuptuar më lehtë përmbajtja e tij në vazhdim po i prezantojmë të gjeturat sipas objektivave të parapara dhe të dakorduara me Menaxhmentin e Universitetit.

Në vazhdim të këtij raporti po i prezantojmë të gjeturat e sipas objektivave të parapara dhe të dakorduara me Menaxhmentin e MAShT-it për Universitetin Publik të Gjilanit për periudhën janar-shtator 2017.

Fokusimi i punës sonë ka qenë i orientuar në ekzaminimin e përgatitjes financiare për gjithë qarkullimin financiar në Universitetin Publik të Gjilanit. Kemi analizuar raportet financiare të përgatitura për periudhën janar-shtator 2017, ku kemi vërejtur se nuk është paraqitur gjendja reale e qarkullimit financiar në Universitetin Publik të Gjilanit.

- **Planifikimi dhe realizimi i buxhetit, çështjet me prioritet të lartë**

**E gjetura**

Sipas vlerësimit tonë dhe të dhënave në tabelë buxheti i ndarë për të gjitha kategoritë ekonomike nuk është shfrytëzuar në mënyrë të kënaqshme gjatë vitit 2017, të gjitha shpenzimet e paraqitura i kemi të siguruara nga Free Balance sepse në Zyrën e Financave të UPGj-së të dhënat nuk kanë qenë të plota dhe të sakta. Kemi hasur në mos planifikim të shpenzimeve dhe regjistrim jo të saktë të tyre në programin Excel.

**Rreziku**: Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i tij mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave përcaktuara të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm

**Rekomandojmë**: Menaxhmentin e Universitetit te Gjilanit të sigurojë që planifikimit të kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e nevojave si dhe faktorëve që ndikojnë në realizimin e Buxhetit. Kjo do të zvogëlonte nevojat për përshtatje të buxhetit përgjate vitit. Klasifikimi i shpenzimeve duhet të bëhet në pajtim me planin kontabël

Menaxhmenti i UPGj-së duhet të siguroj që përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron plotësisht të gjithë informacionin e duhur duke përfshirë edhe shpenzimet e vitit paraprak, pritjet në ndryshimet e vitit etj.

Theks i veçantë duhet të vendoset në identifikimin e pengesave dhe mundësive për të rritur shkallën e duhur të ekzekutimit të buxhetit

Në vazhdim po i paraqesim gjendjen e qarkullimit financiar për UPGj-së bazuar në të dhënat Thesari për arsye se zyrtaret e buxhetit në UPGJ nuk kishin raport të shpenzimeve të pergaditura nga zyrtari i buxhetit prandaj jemi të bazuar në raportet e thesarit dhe në raportet e zyrtarëve të MASHT-it

**Buxheti i ndarë, buxheti i shpenzuar dhe i mbetur janar-shtator për vitin 2015 sipas kategorive ekonomike (programeve)**

| Kategoritë ekonomike | Buxheti i lejuar (€) | Alokimet | Buxh.i shp (€) | obligimet | Buxheti i mbetur (€) | % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pagat dhe mëditjet | 916.353.99 | 820.096.22 | 650.556.19 | - | 69.540.03 | 90% |
| Mallrat dhe shërbimet | 316.339.00 | 212.290.00 | 73.825.93 | 14.389.87 | 126.710.25 | 33% |
| Komunalit | 50.000.00 | 37.250 06 | 15.327.75 | 1.821.22 | 21.695.20 | 44% |
| Subvencione dhe Transferet | 10.0 0.00 | - | - | - | -- | 0% |
| Kapitalet | 250.000.00 | - | - | - | - | 0% |
| Totali | 1.542.692.99 | 975.636.28 | 739.709.87 | 17.980.93 | **217.945.48** | **75%** |



## Realizimit të buxhetit - Prioriteti i Lartë

Edhe pse buxheti ne nëntëmujorin është realizuar në masën 75%, nuk mund të themi se Universiteti I Gjilanit kishte përformancë të mirë buxhetore sipse vlerësimet tonë dhe të dhënave në tabelë buxheti i ndarë për të gjitha kategoritë ekonomike nuk është shfrytëzuar në mënyrë të kënaqshme gjatë periudhës jenar -shtator vitit 2017 përveç te kategoria e pagave, në kategorit tjera perqindja e shpenzimeve është e vogël kurse te kategoria e kapitaleve as që ka ndonjë shpenzim.

**Rreziku**: Realizimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i tij rrezikun që synime dhe objektiva të caktuara të mos realizohen sipas synimeve fillestare

**Rekomandojmë**: Menaxhmenti e UPGj-së dhe Zyrën për Buxhet dhe Financa që të siguroj një program të mirëfilltë të kontabilitetit për regjistrimin e shpenzimeve si dhe në periudhat e ardhshme të respektohet neni 30.1 dhe 30.2 i Ligjit të Menaxhimit të Financave publike dhe Përgjegjësive dhe që planifikimi i buxhetit për vitet e ardhshme fiskale të bëhet nga secili departament/sektor/zyre veç e veç.

Paraqitja e shpenzimeve sipas kodeve ekonomike në Universitetin e Gjilanit për nëntëmujorin e 2017

| | |
|---|---|
| 977 - UNIVERSITETI I GJILANIT | 827,274.72 |
| 11110 - PAGAT NETO PËRMES LIS.PAGAVE | 602,921.15 |
| 11500 - TATI.I NDALUR NE TE ARDH.PERS. | 53,663.28 |
| 11600 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNETORI | 33,753.97 |
| 11700 - KONTRIBUTI PENSIONAL-PUNEDHENE | 33,753.97 |
| 13130 - SHPENZ.UDHË.ZYRT.BRENDA VENDIT | 127.50 |
| 13140 - SHP.E UDHË.ZYRT.JASHTË VENDIT | 4,924.32 |
| 13210 - RRYMA | 11,325.33 |
| 13220 - UJI | 4,427.89 |
| 13230 - MBETURINAT | 48.30 |
| 13250 - SHPENZIMET TELEFONIKE | 640.89 |
| 13310 - SHPENZIMET PER INTERNET | 1,421.71 |
| 13320 - SHPENZIMET E TELEFONIS MOBILE | 5,218.22 |
| 13410 - SHËRBIMET E ARSIMIT - TRAJNIMIT | 483.50 |
| 13450 - SHERBIME SHTYPJE-JO MARKETING | 72.12 |
| 13460 - SHERB KONTRAKTUESE TJERA | 9,468.03 |

| | |
|---|---|
| 13470 - SHERBIME TEKNIKE | 7,202.89 |
| 13480 - SHPENZIMET PER ANETARESIM | 17,760.00 |
| 13509 - PAISJE TJERA <1000 | 3,264.94 |
| 13610 - FURNIZIME PËR ZYRË | 4,742.37 |
| 13780 - KARBURANT PER VETURA | 1,299.02 |
| 13953 - SIGURIMI I NDERTESAVE TJERA | 12,397.02 |
| 14010 - MIREMB.- RIPARIMI I AUTOMJET. | 361.00 |
| 14020 - MIREMBAJTJA E NDERTESAVE | 11,169.32 |
| 14040 - MIREMB.E TEKNOLOGJ.INFORMATIVE | 95.00 |
| 14210 - REKLAMAT DHE KONKURSET | 250.50 |
| 14220 - BOTIMET E PUBLIKIMEVE | 994.56 |
| 14310 - DREKA ZYRTARE | 5,487.92 |

**Çështja 2–Shpenzimi i Parasë së gatshme**

Gjatë periudhës janar-shtator 2017, UPGj-ja ka tërhequr një rimbushje të Petty cash-it në vlerë prej 1.000.00 €. Nga kjo shumë për për periudhën janar-shtator të vitit 2017 janë shpenzuar 293.50 € dhe ne sirtar gjenden 706.50€ ne momentin e auditimit nga Njësia jonë.

Gjatë analizës dhe shqyrtimit të dokumentacionit që ka të bëjë me procedurat e shfrytëzimit të parave të imëta, mund të konstatojmë se:

- në kuadër të UPGj-së nuk ka të emëruar kujdestar të parave të imëta, por ato mbahen nga Zyrtari financiar
- Pagesat janë bërë për shpenzime që lejohen nga paraja e imët në perjashtim te dy rasteve.

**Për këtë çështje sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon**

### Pagesave për Borde dhe Komisione të UPGj-së - Prioritet i lartë

Nga analizat të cilat i kemi bërë përmes të dhënave të SIMFK dhe PAYROLL për bordin që funksionojnë në UPGJ, kemi vërejtur se nga periudha janar-shtator 2017 në total nuk janë paguar më shumë sesa e përcakton UA 12/2007 për Unifikimin e Pagave, Shtesave të kryetarëve, kryesuesve dhe të anëtarëve të bordeve të këshillave e të komisioneve.

**Për këtë çështje sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon**

### Shpenzimet për telefona celular dhe fiks

Shpenzimet e raportuara për muajt janar-shtator për shërbimet e telefonisë fikse dhe mbushjet e telefonave celular janë si vijon:

| | |
|---|---|
| Shpenzimet për telefona fiks | 1.898.22 (janar-shtator 2017) |
| Shpenzimet mujore për mbushjet e telefonave celular janar-shtator 2017 | 3.320.00 |
| **Gjithsejtë:** | ***5.218.22€*** |

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit për shpenzimet e telefonisë fikse për vitin tetor-shtator 2017 në UPGj-së, duke u bazuar në shënimet e ofruara nuk kemi hasur në tejkalime të limitit të lejuar i cili përcakton shpenzimet e telefonisë fikse për shpenzimet e krijuara.

Sa i përket shpenzimeve për kartelat mbushëse për telefona celular është lidhur marrëveshje ndërmjet UPGj-së dhe Valës me dt. 08.11.2013. Kjo marrëveshjë është zhvilluar pa procedura të rregullta të prokurimit pasi që në Republikën e Kosovës ekzistojnë disa operatorë telefonik dhe nga ajo që Njësia e Auditimit ekzaminoj vihet në pah se marrëveshja është lidhur direkt me operatorin Vala.

**Rreziku**: Mos zhvillimi i aktivitetit të prokurimit eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik dhe kështu rrit rrezikun e diskriminimit në dëmë ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

**Rekomandojmë** Menaxhmetin e lartë të UPGj-së që ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente konform Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Pubik në R.Kosovës

## Procedurat e shpenzimeve në UPGj

Nga numri i përgjithshëm i lëndeve te realizuara nga UPGJ kemi testuar një numër te konsiderueshëm te tyre. Analizat dhe ekzaminimi i urdhërpagesave të cilat i kemi audituar tregojnë se procedurat e shpenzimeve për lëndët në UPGj-së kanë funksionim jo të mjaftueshëm të sistemit të kontrolleve të brendshme. Procedurat e prokurimit në kuadër të UPGj-së janë të pergaditura nga një zyrtar i cili punon në një organizat shoqërore dhe punon edhe për Universitetin e Gjilanit me Marrëveshje. Nuk ka zyrtar te prokurimit zyrtarisht.

Janë dy raste kur është shfrytëzuar kontrata e Universitetit te Prishtinës për pastrimin e objektit dhe për sigurim te objektit . Në anën tjeter këto kontratë të cilën e ka shfrytëzuar Universiteti i Gjilani i ka skaduar afati.

**Parregullsi në procedimin e pagesave**

**Te gjeturat**

**Lënda** me nr rendor të kuponit te zotimit 8710 kodi ekonomik 14020 në shumë prej 2.792.33 € pastrimi i objektit, kontrata është e Universitetit të Prishtines të cilës i ka kaluar edhe afati (e lidhur me 01.04.2014 dhe mbaruar me 13.05.2015)

**Lënda** me nr rendor te shpenzimit 170029 kodi ekonomik 14310 dreka zyrtare - Nuk dihet nga kush eshte inicu kerkesa dhe qellimi i kerkeses per drekë zyrtare ,nuk dihet numri i pjesëmarërsve

**Lënda** me nr: te kerkeses 33052 kodi ekonomik 14010 mirëmbajta e automjetit. Kërkesa është e dt. 21.03.2017 fatura e dt. 24.04.2017 ndërsa pagesa është kryer me dt.15.09.2017. Venesa në pagesë

**Lënda** me nr te kerkeses 16892 kodi ekonomik 14020 pastrimi dhe mirëmbajtja shuma 2.792.33. Kontrata apo marrëveshja e UPGJ-së me Universitetin e Prishtinës është e dt.15.05.2015

**Lënda** me nr të kërkesës 2017-8809 kodi ekonomik 13953 sigurimi fizik i objektit në vlerë prej 1.407.72 në muaj. Universiteti i Gjilanit ka një marveshje ne Universitetin e Prishtines me dt.03.06.2015 – Në këtë marveshje nuk caktohet data e perfundimit te kontratës me kompani.

**Lënda** me nr:2017 – 75276 kodi ekonomik 13140 shpenzim i udhëtimit zyrtar në vlerë prej 521.19 aproMimi nga menaxhmeti i Universitetit është i datës 13.12.2016, kërkesa është e dt.13.12.201. Në lëndë mungon raporti i vizitës zyrtare.

**Rekomandojmë** Menaxhmentin e lartë të UPGj-së që të plotësoj me staf të nevojshëm sipas skemës organizative të UPGj-së dhe të funksionalizoj departamentin e prokurimit në mënyrë që të gjitha procedurat e shpenzimeve të udhëhiqen nga UPGj-ja sipas detyrave dhe përgjegjësive që iu takon zyrtarëve të prokurimit dhe të zbatoj me përpikëri dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë Ligji nr.03/L-241

**Çështja 6: Procedurat e personelit**

**3.1.1. Për të rishikuar sistemin e dizajnuar nga Menaxhmenti dhe për të dhënë siguri të arsyeshme se janë duke u zbatuar** Ligji Nr. 03/L-149 - Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullore nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil
Gjatë periudhës janar-shtator 2015 e cila është edhe periudha e rishikuar gjatë auditimit, në kuadër të shërbimit të personelit janë kryer këto aktivitete:

**Kabineti i Rektorit nga periudha janar-shtator 2017 përbëhet me staf prej 1 punonjësve**
***Stafi Akademik:***
*Staf akademik te rregullt gjithsej: 40*
*Staf akademik i angazhuar gjithsej: 65*
*Stafi Administrativ : 18 dhe dy me marrëveshje me shërbime të veçanta*

Kemi analizuar dosjet personale të punësuarve (stafit akademik dhe stafit administrativ). Nuk ka sistematizim të duhur të dokumentacionit. Dosjet janë të shpërndara dhe të vendosura nëpër sirtar të ndryshëm.

**Rreziku**: Kontrollet e dobëta të aplikuara në këtë fushë rrisin dozën e rrezikut se mund të kemi gabime të tjera në sistemimin e administrimit të dokumentacionit të personelit.

**Rekomandohet** Zyrtari i Personelit në UPGj-së, të ndërmarr masat e caktuara për përmirësimin dhe menaxhimin më racional dhe efikas të dokumentacionit të bëj kompletimin e dosjeve të personelit me dokumentet e kërkuara sipas rregulloreve në fjalë

**Përshkrim: Procedurat e konkurrimit për themelimin e marrëdhënies së punës në UPGJ dhe rekrutimi i stafit në shërbim të administratës**

Në punën tonë gjatë auditimit në Zyrën e Personelit, kemi bërë rishikimin dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të konkurrimit për vende të lira të punës për stafin administrativ në UPGj pasi që gjatë peridhës janar-shtator 2017 janë shpallur këto pozita: Menaxher i personelit, Menaxher i prokurimit si dhe zyrtar çertifikues

***Objektiva e procesit***
Rekrutimi i nëpunesve civil duhet të behet sipas Ligjit Nr. 03/L-149 Per sherbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullorja Nr. 02/2010 Për procedurat e rekrutimit ne sherbimin civil

***Kontrollat e brendshme***
Ligji Nr. 03/L-149 Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës
Rregullorja Nr. 02/2010 Për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil
Komisioni për rekrutim.
Menaxhmenti i lartë i Institucionit.

***Rreziku për proces***
Vlesimi jo i saktë nga komisioni për rekrutim
Njohuri jo te mjaftueshme të procedurave nga komisioni për rekrutim
Pranimi i zyrtarëve te rinjë pa i plotesuar kriteret e parapara të konkursit.

Gjatë punës sonë kemi bërë testimin, analizat lidhur me rekrutimin dhe pranimin e nëpunesve të rinjë në UPGj për ta siguruar menaxhentin e lartë se ka funksionim të sistemit të kontrollave të brendshme për këtë proces. Kemi testuar të gjitha mostrat rreth pranimit -rekrutimit te nëpunesve të rinjë.
Gjatë periudhës janar-shtator 2017 është pranuar 1 kandidatë i ri ndërsa për dy kandidatë pas rizgjedhjes së tyre janë anuluar procedurat e përzgjedhjes përfundimtare të kandidtati fitues nga KPM SHCK-ja .

Kolegji i këshillit për vëzhgim ka rekomanduar anulimin e konkursit për arsye të dështimit të vlerësimit të drejtë të dy kandidatëve të cilët kanë hyrë në listen e ngushtë pasi që Universiteti I Gjilanit ka vepruar në kundërshtiim me dispozitat e Ligjit nr/03/L*149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe rregullores Nr/02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Rreziku:** Keqmenaxhimi dhe mos përgjegjësia e KPSHC-së sjellë dëmtim dikrekt të kandidatëve konkurues si dhe pasqyron dobësi domethënëse për Institucionin në fjalë.

**Rekomandim**: Menaxhmenti i lartë duhet të ketë kujdes gjatë përzgjedhjes së komisionit vlerësues pasi që KPSHC-ja duhet të respektoj aktet normative në fuqi dhe të siguroj që procesi i përzgjedhjes të zbatohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe të saktë.

2) Në Divizionin e Burimeve Njerëzore, jemi fokusuar edhe ne analizën dhe testimin e procedurave rekrutuese dhe shohim qartë se Komisionet e formara për rekrutim të stafit kanë mungesë njohurish rreth rekrutimit të stafit dhe mungesë e respektimit të nenit 7 të rregullores 02/2010 ku KPSHC është përgjegjëse për menaxhimin dhe vlerësimin e gjithmbarshme rreth procedurave rekrutuese.

Nga lëndët e audituara vërejmë se vlerësimet e kandidatëve,aplikanëve ne testin me shkrim, nuk kemi vlerësim notues nëpër teste vetëm përmbledhje përfundimtare të pikëve në shkresën zyrtare njoftuese lidhur me kandidatin më të suksesshëm të lëshuar nga UPGj-ja

**Rreziku**: Keqmenaxhimi dhe mos përgjegjësia e KPSHC-së sjellë dëmtim dikrekt të kandidatëve konkurues si dhe pasqyron dobësi domethënëse për Institucionin në fjalë.

**Rekomandim:** Menaxhmenti i lartë duhet të ketë kujdes gjatë përzgjedhjes së komisionit vlerësues pasi që KPSHC-ja duhet të respektoj aktet normative në fuqi dhe të siguroj që procesi i përzgjedhjes të zbatohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe të saktë.

3) Kemi vërejtur mungesë të stafit administrativ nëpër departamente ku një zyrtar është i ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi te llojllojshme si pasojë e mungesës së personelit.

**Rreziku:** Mungesa e stafit reflekton në mosarritje të objektivave të caktuara nga Institucioni si dhe mos kryerja e punëve me kohë.

**Rekomandohet** Menaxhmenti i lartë i UPGj-së që për shkak të detyrave dhe përgjegjësive si autoritet kryesor dhe Menaxhues në Universitet që të plotëson me staf të nevojshëm dhe të rrit numrin e punonjësve brenda Universitetit.

4) Sa i përket stafit akademik në fakultetin e edukimit sipas konkursit të shpallur në veb faqen e universitetit për pranimin e mësimdhënesve të angazhuar në fakultetin e edukimit për semestrin dimëror për vitin kademik 2016-2017 janë kërkuar 15 mësimdhënes ndërsa janë pranuar 2 prof ass., 1 prof i rregullt dhe 8 ligjërues. Pra janë pranuar 11 në total. Pra Ndërsa për konkursin e shpalluar si asistent me angazhim të përkohshëm janë kërkuar 11 asistent ndërsa janë pranuar 12.

Në fakultetin e shkencave kompjuterike janë kërkuar 5 mësimdhënës sipas konkursit ndërsa janë pranuar 2 mësimdhënës si asistent janë kërkuar 5 asistentë ndërsa janë pranuar 6.
Në fakultetin juridik janë kërkuar sipas konkursit 10 mësimdhënës ndërsa janë pranuar 10 prof.dhe tre ligjërues pra 13 në total ndërsa asistent janë kërkuar 5 ndërsa janë pranuar 4 asistent në lënd të ndryshme për angazhim.

Në fakultetin ekonomik janë kërkuar 17 mësimdhënës ndërsa janë pranuar pesë prof. dhe dy ligjërues gjthsej 7 ndërsa asistent janë kërkuar 11 sipas konkursit ndërsa janë pranuar 18 asistent.

Në fakultetin e shkencave kompjuterike janë kërkuar 5 mësimdhënës sipas konkursit ndërsa janë pranuar 2 mësimdhënës si asistent janë kërkuar 5 asistentë ndërsa janë pranuar 6.

Sa i përket dosjeve të të pranuarve kemi hasur në parregullësi të ndryshme. Në disa raste kemi dosje të kompletuara pra nuk iu mungon dokumentacioni relavant por kemi mbi 90% të rasteve kur kandidatët e angazhuar janë angazhuar pa komision recenzues për semestrin dimëror.
Kemi edhe raste kur mungon dosja komplet për disa profesor.

Sipas procesverbalit nga inspektimi special i dt.24.10.2016 lidhur me angazhimin e mësimdhënësve dhe asistentëve për semestrin dimëror të vitit akademik 2016-2017 si dhe konkursin e shpallur më 06.10.2016-Ref. Nr.03-874 vërejmë shumë parregullësi mirëpo gjatë procesit të auditimit vërejmë se disa nga të gjeturat nga Inspektoriati janë eliminuar p.sh dosjet e disa punonjësve janë plotësuar me dokumentacionin relavent përkatës (diplomat gjenden në dosje).

Konstatim: Sipas testimit të dosjeve kemi konstatuar se nuk është respektuar Neni 6 i rregullores Ref.nr.01/1474 e dt.09.12.2015 për zgjedhjen e personelit akademik në Universitetin Publik të Gjilanit lidhur me komisionin recenzues për angazhimin e personelit akademik. Nuk janë formuar komisione recenzuese andaj edhe mungojnë vendimet e komisioneve.

